



Prishtinë, 12 qershor 2024
Kodi i ZRRE-së: V_2757 _2024

Bordi i Zyrës së Rregullatorit për Energji

Mbështetur në Nenin 9 paragrafi 1 nënparagrafi 1.7, Nenin 15 paragrafi 1 nënparagrafi 1.15, Nenin 25, Nenin 26 paragrafi 1 nënparagrafi 1.2 dhe Nenin 43 paragrafi 1 të Ligjit për Rregullatorin e Energjisë (Nr.05/L-084); Nenin 19 paragrafin 2 të Rregullës Nr. 03/2022 për Procedurën e Autorizimit për Ndërtimin e Projekteve të Energjisë, Vendimi për Lëshimin e Autorizimit V_1778_2023 të datës 31 tetor 2023 për shoqërinë "VITA ENERGY" SH.P.K., për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Kodra e Hutit, komuna e Gjakovës dhe kërkesën për shtyrjen e afatit të vlefshmërisë së Vendimit për Autorizim V_1778_2023 edhe për 12 (dymbëdhjetë) muaj, për ndërtimin e kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Kodra e Hutit, komuna e Gjakovës, të datës 22.05.2025 nr. prot. 432/25 të shoqërisë "VITA ENERGY" SH.P.K., me adresë: Lagjja Marigona Residence, Preoce, Graçanicë, Republika e Kosovës; dhe

në seancën e mbajtur më 12 qershor 2025 nxori këtë:

V E N D I M

- I. **APROVOHET** – kërkesa e shoqërisë "VITA ENERGY" SH.P.K., dhe **SHTYHET** afati i vlefshmërisë së autorizimit V_1778_2023 të datës 31 tetor 2023 për vazhdimin e ndërtimit të kapaciteteve të reja gjeneruese për prodhimin e energjisë elektrike nga panelet solare/fotovoltaike me kapacitet të instaluar prej 3 MW ZK Kodra e Hutit, komuna e Gjakovës.
- II. **OBLIGOHET** - shoqëria "VITA ENERGY" SH.P.K., që brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimi të këtij Vendimi për vazhdim të afatit të vlefshmërisë së Vendimit V_1778_2023, që të dorëzoj garancionin financiar në vlerë prej 7% të vlerës së projektit, të lëshuar nga një Bankë Komerciale e licencuar apo kompani e sigurimeve në Republikën e Kosovës, me vlefshmëri që mbulon periudhën sipas Planin Dinamik të Realizimit të dorëzuar nga Aplikuesi.
- III. Garancioni financiar sipas pikës II. të këtij Vendimi, do të jetë në vlerën prej 123,200.00€ (njëqind e njëzetetremijë e dyqind Euro), sipas vlerës së projektit të prezantuar me Planin e Biznesit me rastin e aplikimit për Autorizim dhe duhet të mbulon periudhën deri **31.10.2025**.
- IV. Kushtet tjera të vendosura me Vendimin V_1778_2023 mbesin të pa ndryshuara dhe duhet të zbatohen nga aplikuesi.



Arsyetim

- ZRRE me datë 22.05.2025 nga "VITA ENERGY" SH.P.K., ka pranuar kërkesën për zgjatjen e Planit Dinamik për ndërtimin e kapaciteteve Gjeneruese fotovoltaike me kapacitet 3 MW, sipas Vendimit V_1778_2023 të datës 31 tetor 2023.
- ZRRE ka analizuar kërkesën për shtyrje të afati të vlefshmërisë së autorizimit, ku aplikuesi ka sqaruar se për shkak të pengesave faktike në gjetjen e financimit të projektit, për shkak se bankat lokale kanë shfaqur fillimisht hezitim të financimit të projekteve të tilla, ashtu që nuk kanë mundur të parashikojmë një situatë të tillë, pasi që nuk është në interes që të dalin jashtë Planit Dinamik të realizimit.
- Po ashtu kanë theksuar se pas pranimi të vendimit për autorizim ka filluar përgatitjet dhe kanë dërguar dokumentacionin përkatës në Raiffeisen Bank, për të finalizuar financimin, në mënyrë që të përmbushin obligimet sipas vendimit përkatës. Mirëpo përgjatë kësaj faze të gjetjes së financimit, kanë hasur në disa vështirësi financiare, dhe është dashur kohë për të realizuar kredinë.
- Përkundër kësaj Kompania i ka ndërmarr të gjitha veprimet e nevojshme për gjetjen e financave ashtu që më datë 21.11.2024 ka nënshkruar kontratën e kredisë "Marrëveshjen për kredinë", nr. 903329/810653, me Bankën Raiffeisen Bank në vlerë prej 1,250,000 Euro, të cilën si dëshmi e kanë bashkëngjitur s' bashku me kërkesën.
- Gjithashtu kanë theksuar se me datën 20.05.2024 kompania ka nënshkruar kontratën për ndërtimin e projektit, ashtu që sipas planit dinamik të nënshkruar nga palët, ndërtuesi e ka marrë përsipër që të finalizoj ndërtimin, jo më larg se data 24.10.2025. Janë bashkëngjitur Kontrata për ndërtim, Plani dinamik dhe fotografi nga vendi i ngjarjes.
- Po ashtu sa i përket Garancionit bankar, ka njoftuar se Banka Ekonomike e cila ka lëshuar garancionin bankar në favor të ZRRE-së, lidhur me ndërtimin e Projektit nga kompania VITA ENERGY, me datën 16.05.2025 ka dërguar email, ku theksohet se duhet të sigurohet vazhdimi i afatit të autorizimit për konfirmim të garancionit, për mbulimin e periudhën së ndërtimit.
- Kërkesës për shtyrje e kanë bazuar në Rregullën nr. 03/2022 për procedurën e autorizimit për ndërtimin e projekteve energjetike, respektivisht Nenin 19.1, që parasheh që autorizimi i lëshuar nga ZRRE është i vlefshëm për periudhën 24 muajsh, dhe sipas Nenit 19 par. 2 Aplikuesi mund të kërkojë që të vazhdojë afatin e përcaktuar me par. 1, edhe për 12 muaj të tjerë, me arsye se një zgjatje e tillë ka qenë jashtë kontrollit të aplikuesit. Prandaj kanë kërkuar se afati të shtyhet për një periudhë shtesë, për finalizimin e projektit.
- Bordi i ZRRE-së, pas vlerësimit të kërkesës për shtyrje të afatit të Autorizimit, dëshmime të bashkëngjitura dhe raportit të monitorimit, ka ardhur në përfundim se në aspektin administrativ dhe arsyeve faktike të prezantuar nga dëshmitë përkatëse duke pasur parasysh edhe vonesat në sigurimin e pjesës së kreditimit nga institucionet financiare për realizimin e projektit të prezantuar nga aplikuesi, të cilat veprime vlerësohen se janë jashtë kontrollit të aplikuesit, duke u mbështetur në dispozitat ligjore të cekura në hyrje të këtij Vendimi, ka vendosur si në dispozitiv të këtij Vendimi.

V. Vendimi nxirret dhe publikohet në gjuhët zyrtare në Republikën e Kosovës.


VI. Vendimi hyn në fuqi në datën e miratimit nga Bordi, dhe do të publikohet në faqen elektronike zyrtare të ZRRE-së.





Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim mund të inicioj konflikt administrativ në Gjykatën Kompetente, brenda tridhjetë (30) ditëve nga data e pranimit të Vendimit ose data e publikimit të tij në faqen elektronike të ZRRE-së, cilado që ndodh e fundit.


Bordi i ZRRE-së:


Ymer Fejzullahu, Kryesues


Lutfije Dervishi, Anëtare


Gani Buçaj, Anëtar


Arta Isufi, Anëtare


Adnan Preniqi, Anëtar

Vendimi iu dërgohet:

- Palës,
- Komunës së Gjakovës,
- Sekretarit të Përgjithshëm të MMPHI-së, dhe
- Arkivit të ZRRE-së.